

FJALA E DEPUTETES ETILDA GJONAJ

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

E nderuar zonja zëvendëskryetare e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Do të ishte në nderin tonë që debati i sotëm për progresraportin e Shqipërisë në rrugëtimin europian të zhvillohej normal një herë të vetme. Ne duhet të diskutojmë si çdo vend që e ka kaluar këtë proces për të vlerësuar aspektet pozitive, për të thënë çfarë nuk ka shkuar mirë apo masat që duhen marrë për të forcuar shtetin e së drejtës dhe për ta bërë Shqipërinë një vend me një ekonomi të fortë dhe të qëndrueshme. Me marrjen e vendimit historik të 19 korrikut për hapjen e negociatave dhe përcaktimin e kuadrit negociues me BE-në të gjithë presim që debati të jetë konstruktiv dhe të shikojmë bashkërisht çfarë duhet të bëjmë për ta përshpejtuar këtë proces, duke marrë modelet më të mira të vendeve të anëtarësuaras rishtazi.

E gjithë klasa politike duhet të bëjë ndryshime në diskutime kur bëhet fjalë për rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE-së, të vlerësojë arritjet e vlerësuara nga palët e paanshme dhe me gjykim objektiv, siç janë partnerët tanë nërkombëtarë. Do të ishte normale, siç ndodh edhe në vendet e tjera, që fjalët e Presidentes Von Der Leyen për vlerësimin e progresit të Shqipërisë në forcimin e shtetit të së drejtës, në reformën shumë të rëndësishme të drejtësisë, që konsiderohej si një parakusht i domosdoshëm për progresin e integritimit europian të Shqipërisë, t'i dëgjonim edhe nga opozita në këtë parlament.

Do të ishte shumë mirë që vlerësimet e komisionerit Vareli, i cili deklaroi: "Shqipëria ka vijuar të bëjë një progres të mirë, duke marrë rezultate të dukshme; reforma në drejtësi dhe procesi i vetingut po vijnë punën në mënyrë konstante dhe janë shembull i progresit të mirë; Shqipëria ka treguar nivel të lartë përkushtimi për përforcimin e ligjit, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; ka mbajtur 100% linjën europiane për pushtimin rus të Ukrainës", pra t'i dëgjonim edhe nga opozita në këtë parlament. Opozita duhet të flasë pozitivisht për Samitin e 6 dhjetorit, që jo pa qëllim po organizohet në Tiranë. Do të ishte shumë mirë që opozita t'i thoshte deklaratat e përfaqësuesit të lartë të BE-së për sigurinë, zotit Borelli, i cili shprehu se Shqipëria ka qenë një zë moderator dhe moderues në një rajon të

kompleksuar, duke ndihmuar në dialogun Kosovë-Serbi dhe do të ishte mirë që sado ndryshe të kuptohej ky progresraport, disa çështje të rëndësishme të lexohen ose të interpretohen siç janë.

Në progresraport theksohet se qeveria ka treguar përkushtim ndaj vlerave të Bashkimit Europian dhe rrugën e saj të reformave, pavarësisht sfidave ekonomike dhe sociale të tri krizave të njëpasnjëshme; ka përforcuar strukturën koordinuese për BE-në me emërimin e një ministri Shteti, i cili bashkë me grupin negociator ndjek të gjithë procesin teknik të vlerësimit të legjislacionit dhe kuadrit negociues. Në progresraport ne lexojmë edhe rekomandimet që duhet të ndiqen për të avancuar me agjendën e integritit europian, ku qeverisë i kërkohet të vijojë agjendën e reformave bashkë me opozitën dhe shoqërinë civile; jemi të vetëdijshëm që është e nevojshme rritja e ekspertizës dhe tërheqja e ekipeve më të mira për procesin e negociatave të aderimit.

Në progresraport është thënë qartësisht se vendi ka bërë progres në 32 nga 33 kapitujt e negociatave dhe në 2 kriteret e procesit të integritit, ku pa dashur të përfshijë krahasimin, Shqipëria ka pasur progresin më të mirë krahasuar me vendet e rajonit. Më lejoni të përmend në këtë diskutim disa nga çështjet më të rëndësishme që përmban ky progresraport. Po filloj me politikën e jashtme, për të cilën progresraporti jep rekordet më pozitive, duke theksuar që Shqipëria ka arritur të mbajë rekordin e saj për përafrimin e plotë me politikën e BE-së për çështjet e jashtme dhe sigurinë në rolin e saj aktiv në Këshillin e Sigurisë në OKB. Për kapituj themelorë Shqipëria ka marrë një vlerësim shumë të mirë krahasuar me vendet e tjera të rajonit.

Reforma në drejtësi vlerësohet më mirë jo vetëm për përgatitjen, por edhe për progresin, duke e konsideruar atë vetëm një vlerësim poshtë atij që konsiderohet vlerësim maksimal, pavarësisht se e dimë që reforma në drejtësi ka ende punë për të përfunduar zbatimin e saj, sidomos në atë që konsiderohet efienca e sistemit, duke përfshirë mirëfunksionimin, llogaridhënien dhe transparencën e institucioneve të pavarura të drejtësisë, si dhe në konsolidimin e rezultateve. Duhet theksuar vlerësimi pozitiv që progresraporti i ka njohur rolit të parlamentit për bashkëpunimin midis maxhorancës dhe opozitës për miratimin e zgjatjes së afatit të organeve të vetingut; kjo duhet të bëjë që institucionet që e kryejnë këtë proces, të ndiejnë më shumë përgjegjësi për të përmbushur sa më shpejt misionin e tyre.

Plotësimi i Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, duke u futur në shinat normale të funksionimit të tyre, kanë shënuar progres të evidentuar në raport, duke njohur edhe rezultatin pozitiv që Gjykata e Lartë për herë të parë në 6 vjet ka ulur ngarkesën e çështjeve. Prokuroria dhe Gjykata e Posaçme, tashmë funksionale në kuadrin ligjor, strukturat, buxhetin dhe infrastrukturën, kanë shënuar rezultate të

mira në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe patjetër, sipas progresraportit, rekomandohet të vijojë ndërtimi i një bazë të konsoliduar, sepse ka ende punë për të ndryshuar një herë e mirë kulturën e pandëshkueshmërisë, që në sistemin e kaluar ishte një praktikë e konsoliduar. Po ashtu, është vlerësuar si një progres i mirë bashkëpunimi i vendit tonë me strukturat e shteteve anëtare të Bashkimit Europian, siç janë: Eurojust dhe Europol në luftën kundër krimit të organizuar.

Shqipëria ka shënuar progres të mirë në zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale, pavarësisht masave që duhet të marrë në vijim për të përafuar legjislacionin, për të ulur ekonominë informale apo për të rritur ekspertizën sipërmarrëse dhe teknologjike. Progres i mirë është arritur edhe në tregun e brendshëm ku nga 9 kapituj, 8 vlerësohen me progres. Progresraporti vlerëson se është bërë progres në kapitujt e konkurrueshmërisë dhe rritjes gjithëpërfshirëse në agjendën digjitale 2022-2026 dhe në agjendën e gjelbër, e cila vlerëson edhe nismën e fundit të ndërmarrë nga qeveria për incentivimin e paneleve diellore.

Të nderuar kolegë,

Është fakt që ky është progresraporti më i mirë që kemi pasur për Shqipërinë, jo vetëm në këndvështrimin krahasues me 1 vit më parë, por edhe në krahasim me vendet e rajonit, ku nuk kemi shënuar progres të dukshëm dhe nuk kemi asnjë regres të monitoruar nga BE-ja, e cila do ta kthente mbrapsht procesin. Këto janë fakte. Patjetër që do të dëshironim të kishim te 33 kapitujt vlerësimin e progresit maksimal, por nuk do të ishim sot këtu në këtë fazë të procesit, por të ulur në tavolinën vendimmarrëse të 27 anëtarëve të BE-së. Pa dyshim, ka një sërë rekomandimesh shoqëruar me reforma dhe nisma sektoriale që po adresohen nga qeveria për këtë proces, ku me rolin e posaçëm të Kryenegociatores dhe grupit negociator, me përgjegjësi, është bërë një punë profesionale, e vlerësuar edhe nga partnerët e Komisionit Europian.

Jemi vetëm në 3-mujorin e parë nga hapja e negociatave me Shqipërinë dhe e dimë që ky proces nuk zgjat disa muaj, 1 vit apo 2 vjet, por është tejet i vështirë dhe kërkon përfshirjen e të gjithë aktorëve politikë, me ekipet më të mira të ekspertëve, për ta çuar përpara agjendën europiane. Gjithëpërfshirja e palëve politike na ngarkon të gjithëve bashkë, dhe jo pa qëllim kryesimi i Komisionit të Integritetit i është besuar opozitës, për të pasur të gjitha instrumentet institucionale dhe politike, për të qenë pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Nga muaji shtator i këtij viti, ne, deputetët anëtarë të Partisë Socialiste, anëtarë të Komisionit të Integritetit, që nuk mungojmë në asnjë mbledhje, bashkë me kryetaren e komisionit, zonjën Tabaku, dhe disa kolegë të grupeve të tjera parlamentare të opozitës, po punojmë

për të ridimensionuar rolin e parlamentit në këtë proces, duke përfshirë të gjithë aktorët politikë, që roli i komisionit të jetë më i dobishëm për të përshpejtuar procesin e integritit evropian.

Ne mund të mos biem dakord ditë e natë për arsye të agjendës politike; mund të debatojmë pa fund për çfarë është arritur dhe çfarë duhet të bëhet më mirë, por jo për të ardhmen e procesit të integritit evropian, jo në kurriz të vendit tonë. Ky nuk është procesi ynë. Ne kemi përgjegjësi vetëm për ta çuar përpara, por ky është procesi i shqiptarëve, të cilët presin që Shqipëria të hyjë në familjen e madhe europiane dhe është proces i së ardhmes së fëmijëve tanë, të cilëve nuk mund t'ua mohojmë këtë gjë. Unë nuk do të lodhem duke përsëritur dhe ritheksuar se agjenda europiane është agjendë e Shqipërisë dhe e shqiptarëve, e cila duhet të na bashkojë për të bërë të mundur që Europa të ndërtohet plotësisht këtu. Ne e kemi mundësinë, detyrimin dhe kohën e duhur për ta bërë këtë gjë. Faleminderit!